



**VENDIM**  
**Nr. 87, Datë 30.06.2015**

**PËR**  
**REFUZIMIN E KERKESËS PËR LIÇENSIMIN E SHOQËRISË**  
**“PHOENIX PETROLEUM” SH.A. NË AKTIVITETIN E**  
**TREGTIMIT TË GAZIT NATYROR**

Në mbështetje të nenit 14, pika 1, germa “ç”, të Ligjit Nr. 9946, date 30.06.2008 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, si dhe neneve 4, pika 1, germa “ç”; 11 dhe 12, të “Rregullave dhe Procedurave për Liçensimin, Ndryshimin, Transferimin e Pjesshëm ose të Plotë, Heqjen dhe Rinovimin e Liçensave në sektorin e Gazit Natyror“, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 09, date 11.02.2011, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 30.06.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “PHOENIX PETROLEUM“ sh.a, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e tregimit të gazit natyror të kësaj shoqërie,

**Konstatohet se:**

Aplikimi i shoqërisë “PHOENIX PETROLEUM” sh.a, plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në Rregulloren për Procedurat e Liçensimit, Ndryshimit, Transferimit të pjesshëm ose të Plotë, Heqjen dhe Rinovimin e Liçensave në Sektorin e Gazit Natyror, si më poshtë:

- **Nga dokumentacioni ligjor, administrativ dhe pronësor mungojnë:**
  - Dokumentacioni që tregon titujt e pronësisë mbi tubacionet e transmetimit të gazit në referim të nenit 9 pika 1, germa “d”/v.
  - Dokumentacioni për lejet dhe autorizimet mjedisore në referim të, nenit 9, pika 1, germa “d”/vi.
- **Nga dokumentacioni për garancitë financiare dhe fiskale mungojnë:**
  - Deklaratë e lëshuar nga sigurimet shoqërore dhe tatim –taksat në referim të nenit 9, pika 1, germa e/i.

- Garancinë e përshtatshme financiare dhe garancia e performancës në referim të Nenit 9, pika 1, germa e/iii.
  - Certifikatë sigurimi nga shoqëri sigurimesh, për jo më pak se 10 milionë USD, në referim të Nenit 9, pika 1, germa e/iv.
  - Vërtetim të kryerjes së pagesës së aplikimit në ERE , në referim të Nenit 9, pika 1, germa e/v.
- **Nga dokumentacioni për të dhënat specifike sipas tipit të liçensës mungojnë:**
    - Sasia mesatare e gazit natyror të shprehur në milion m<sup>3</sup> e parashikuar për tu lëvruar gjatë një viti, në referim të Nenit 9, pika 2, germa “e”/i.
    - Garancia që cilësia e furnizimit me gaz përmbush kriteret minimale të operatorit të sistemit, në referim të Nenit 9, pika 2, germa “e”/ii.
    - Kapitali financiar dhe mbështetja financiare e nevojshme për kryerjen e aktivitetit, në referim të Nenit 9, pika 2, germa “e”/iii.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të refuzojë kërkesën për licensimin e shoqërisë “PHOENIX PETROLEUM sh.a. në aktivitetin e Tregimit të Gazit Natyror me shumicë.
2. Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-s**  
**Petrit AHMETI**